



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.527/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët; Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat Anr.527/2025, Anr.528/2025, Anr.529/2025, Anr.530/2025, Anr.531/2025 të datës 10.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.527/2025, Anr.528/2025, Anr.529/2025, Anr.530/2025, Anr.531/2025, të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në ankesën Anr. 527/2025, pala ankuese pretendon se me datën 09 shkurt 2025, në vendvotimin 1907/02, aktivistja e Lëvizjes Vetëvendosje, pas hapjes së këtij vendvotimi, ka shfaqur material të subjektit Lëvizja Vetëvendosje, ku në mbështjellësin e telefonit të saj ka të vendosur një shenjë me mbishkrimin "5001K" duke ndikuar qëllimisht tek votuesit përmes shfaqjes së parullave të këtij subjekti politik dhe në këtë mënyrë ka cenuar rëndë dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Provë: Fotografi nga qendra e votimit 1907/02, në të cilën vërehet një femër e cila mban në mbështjellësin e telefonit të saj një shenjë me mbishkrimin "500k"; Parashtruesi i ankese thekson se shfaqja e emrit të subjektit politik, të vendosur në mbështjellësin e celularit, përbën qëllim për ndikim të votuesit dhe cenon rëndë përcaktimin e lirë të votuesit.

Në ankesën Anr.528/2025, pala ankuese pretendon se me datë 09 shkurt 2025, mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Bajram Rexhepi, ka komentuar në një nga postimet e Sekretares së Partisë Demokratike të Kosovës, znj. Vlora Çitaku, në të cilën shkruan: "PO ashtu është si ambasadore e ka keqpërdor pozitën e vet, dhe është ber vegël e prostucionit". Si dëshmi ka bashkangjitur provë: Komenti i bërë në Postimin e publikuar në Facebook, të znj. Vlora Çitaku, Sipas parashtruesit të ankesës përmbajtja e këtyre deklaratave pa mëdyshje përbën përdorim të gjuhës fyese dhe denigruese ndaj subjekteve kundërshtarë politike, përmes së cilave ka cenuar rëndë integritetin dhe dinjitetin e Sekretares së Partisë Demokratike të Kosovës znj. Vlora Çitaku.

Në ankesën Anr.529/2025, pala ankuese pretendon se me datë 09 shkurt 2025, në ora 16:40/, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht këshilltar politik i Kryeministrit, z. Luan Dalipi, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, me tekstin përshkrues "Veç gjysmë ore ju duhet për të votuar dhe për të ndikuar në qeverisjen e katër viteve të ardhshme! Në një mandat 4-vjeçar ka afër 500 mijë\* minuta pune. Pra, votimi juaj kërkon vetëm 0.01% të kësaj kohe. Nuk ka kthim të investimit më të mirë se kaq për të ardhmen tuaj! Dilni dhe votoni! Për mos me ju shku mendja që ai 500 mijëshe po lidhet me diçka dhe për juve që i doni detajet, ja llogaritjet. Parshtruesi i ankesës pretendon se me këto veprime ka bërë thirrje në mënyrë indirekt për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje. Provë: Postimi i publikuar nga z. Luan Dalipi, në rrjetin social Facebook <https://www.facebook.com/luan.dalipi.7/posts/pfbid0K1I1gl-Y4TzLbyKgFAMDes16iWTdkMZ5mnP1G6bfQDBcZWzeA2mMJM2PRD1IJox9Qbl;>

Në ankesën Anr.530/2025, pala ankuese pretendon se me datë 09 shkurt 2025, në ora 17:06, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht këshilltar i jashtëm politik i Kryeministrit, z. Bekim Qoku, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/, me tekstin përshkrues "Miq e dashamirë, kanë mbetur edhe 2 orë për të mbushur kutitë me 5001k. Mos prisni momentin e fundit. Dilni sa më parë, ju lutem, ftoni apo merrni me vete edhe të tjerët në vendvotim, Telefononi ata që i keni larg dhe kujtojuani rëndësinë e angazhimit të tyre për të votuar. Albin Kurti nuk mund të na ndihmojë pa e ndihmuar ne atë cep më cep me zemrën plot", duke bërë thirrje për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje. Provë: Postimi i publikuar nga z. Bekim Qoku, në rrjetinsocialFacebook <https://www.facebook.com/bekim.qoku.9/posts/pfbid0yoiu85kevLVnM9bvefZQyUBnrnDrHBZ4vGS63jC2YMy7P5tEeLvE21aBë6AëFSoy81;> PDK vlerëson se në veprimet e mbështetësit të Lëvizjes Vetëvendosje janë konsumuar gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 37, par. 1, nën par. 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në ankesën Anr.531/2025, pala ankuese pretendon se me datë 09 shkurt 2025, në ora 11:54, mbështetësja e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, znj. Nita Bllacaku, ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00,

me tekstin përshkrues "Sa ka bo Leonora Shabani Bajraktari per ket shoqni sun e bojn as 500 veta bashke, kështu qe mos harroni 53 duke bërë thirrje subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, respektivisht kandidatja znj. Leonora Shabani Bajraktari nga radhët e këtij subjekti politik. Provë: Postimi i publikuar nga znj. Nita Bllacaku, në rrjetin social Facebook;  
Sipas parashtruesit të ankesës bërija e fushatës në çfarëdo mënyrë, pas hapjes së qendrave të votimit, respektivisht pas orës 07:00, përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përcaktuar në LZP dhe rregulloret përkatëse.

Në përgjigje e subjektit politik LVV për ankesën Anr 527/2025 subjekti Politik LVV ka theksuar se Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojnë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Fillimisht duhet theksuar faktin se pretenduesi ka dështuar të dëshmojë se personi në fjalë, është aktiviste e LVV. Për më shumë e njëjta, në telefonin e saj personal, duket ta ketë shenjë përkatëse, mirëpo që asnjëherë nuk ka shpërfaqur atë vizualisht dhe demonstrativisht, rrjedhimisht nuk ka pasur qëllimin që të ndikojë në votuesin.

Në përgjigje e subjektit politik LVV për ankesën Anr 528/2025 subjekti Politik LVV, ka theksuar si Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Z. Rexhepi nuk është aktivist, mbështetëse apo pjesë e strukturave të LVV, dhe i cili mund të jetë një votues i tillë, mirëpo që asnjëherë ky fakt, nuk e kualifikon si pjesë, aktivist apo mbështetë, për veprimet e të cilit, LVV do të duhej gjobitur.

Në përgjigje e subjektit politik LVV për ankesën Anr 529/2025 subjekti Politik LVV, ka theksuar se Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Lëvizja VETËVENDOSJE! ka njoftuar dhe trajnuar të gjithë strukturën dhe aktivistët për rregullat zgjedhore, në veçanti ato të cilat kanë të bëjnë me respektimin e heshtjes zgjedhore. Për më shumë, posti i tillë me tekstin përkatës, nuk përmban numër apo ndonjë shenjë të subjektit për të promovuar subjekti politik, dhe rrjedhimisht, nuk bie në kuadër të shkeljeve përkatëse. Është vetëm një thirrje për ta shfrytëzuar të drejtën demokratike të votimit.

Në përgjigje në ankesë për ankesën Anr 530/2025 subjekti Politik LVV, ka theksuar 1. Si Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. z. Qoku është deputet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe i cili nuk bën pjesë në strukturat e LVV në Kosovë, i cili, ka shfrytëzuar të drejtën demokratike për të bërë thirrje për të votuar. Fakti që z. Qoku është deputet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe i cili nuk bën pjesë në strukturat e LVV në Kosovë, mund të vërehet më një shikim të thjeshtë në llogarinë e saj në rrjetin social Facebook.

Në përgjigje e subjektit politik LVV për ankesën Anr 531/2025 subjekti Politik LVV, ka theksuar Si Lëvizje VETËVENDOSJE! vlerësojmë se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta

ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Për më shumë, znj. Bllacaku për asnjë moment nuk ka qenë pjesë e LV, qoftë aktiviste apo në strukturat e LVV dhe kjo mund të vërehet më një shikim të thjeshtë në llogarinë e saj në rrjetin social Facebook.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.527/2025, Anr.528/2025, Anr.529/2025, Anr.530/2025, Anr.531/2025 të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.527/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara kundër subjektit të njëjtë politik LVV për shkeljet e njëjta, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se :

#### **-Ankesat janë të pabazuara.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa nuk është arritur që të vërtetohen se janë shkelur dispozita e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 si dhe dispozita e nenit 37 par. 1 nën par. 1.2 të LZP-së.

Me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërit si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së ku përcaktohet se *“1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës me ankesën Anr 527/2025, me të cilën thekson se aktivistja e Lëvizjes Vetëvendosje, ka shfaqur material të subjektit LVV, në mbështjellësin e telefonit të saj dhe ka të vendosur një shenjë me mbishkrimin "5001K" dhe se e njëjta ka ndikuar qëllimisht tek votuesit, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga fotot e ofruara si dëshmi nuk ka arritur që të vërtetohet se e njëjta ka ndikuar apo ka ndërmarr ndonjë veprim tek votuesit për të ndikuar në mënyrën se si të votojnë ata.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës me ankesën Anr 528/2025 me të cilën thekson se mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje Bajram Rexhepi, ka komentuar dhe ka

përdorur gjuhe fyese dhe denigruese në një nga postimet e Sekretares së PDK-së, znj. Vlora Çitaku, Paneli i vlerësoj se janë te pabazuara per faktin se nga hetimi i ndërmarr nga Paneli nuk ka arritur qe ta gjejë dhe ta verifikoj se personi në fjale është mbështetës i subjektit politik LVV.


Pretendimet ankimore të parashtruesit te ankesës me ankesën Anr 529/2025 me te cilën thekson se mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht këshilltar politik i Kryeministrit, z. Luan Dalipi, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook me të cilën benë thirrje qe të votohet subjekti politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë refuzon per faktin se në postimin e tij i lartpërmenduri nuk ka bërë thirrje që të votohet subjekti politik LVV, por se vetëm ka bërë një postim i cili nuk mund të konsiderohet thirrje për të votuar ndonjë subjekt të caktuar politik apo subjekti politik LVV.

Pretendimet ankimore të parashtruesit te ankesës me ankesën Anr 530/2025 me te cilën thekson se mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht këshilltar i jashtëm politik i Kryeministrit, z. Bekim Qoku, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, me të cilën benë thirrje që të votohet subjekti politik LVV, Paneli ka refuzuar ankesën kjo pasi që i referohet mbështetësit që është qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili mund të jetë mbështetës i subjektit politik në vendin tone, por i njëjti nuk ka të drejtë vote në vendin tonë e rrjedhimisht nuk mund te konsiderohet mbështetës sipas ligjit te Republikës se Kosovës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit te ankesës me ankesën Anr 531/2025 me te cilën thekson se mbështetësja e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, znj. Nita Bllacaku, ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, e cila ka për qëllim të ndikimit tek votuesit për të votuar subjektin politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë te pabazuara per faktin se nga hetimi i ndërmarr nga Paneli nuk ka arritur qe ta verifikoj se e njëjta është përkrahëse e subjektit politik LVV dhe se e njëjta ka bere postimin e pretenduar me ankesë .

Andaj Paneli vlerësoi se ankesat janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur nuk mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara për të cilat referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
Anr.527/2025, datë 12.02.2025



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tete (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.